



Procesverbal i debatit publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore në Lluzhan dhe i fshatrave përreth

Dëgjimin publik e hap drejtori për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani, duke ju uruar mirëseardhje pjesëmarrësve.

Drejtori Osmani thekson se është periudha e hartimit të Kornizën Afatmesme Buxhetore, ku paraqiten projektet prioritare të Komunes së Podujevës për tri vitet e ardhshme, duke përfshirë vitin 2023-2025, ku në vazhdën e diskutimeve publike po marrin kërkesat dhe nevojat prioritare të qytetarëve në menyrë që të përfshihen sa më shumë KAB.

Korniza i paraprinë hartimit të buxhetit të komunës së Podujevës për vitin 2023, dhe si e tillë duhet të aprovohet deri me 30 qershor.

Në bazë të Qarkores Buxhetore të lëshuar nga Ministria e Financave është një lajm i mirë që komuna e Podujevës për vitin 2023 ka një rritje të buxhetit për afér 4 milion euro, dhe buxheti për vitin 2023 do të jetë mbi 27 milion dhe vazhdon më një rritje progresive në vitet 2024 dhe 2025.

Fushat prioritare janë Arsimi, Shëndetësia, Kultura dhe Ekonomia por gjithmonë duke përfshirë edhe projektet infrastrukturore, do të kemi rritje në kategorinë e subvencioneve.

Kab ndërtohet mbi bazën e limiteve buxhetore që jep Ministria e Financave mirëpo është edhe kërkesa që i bahet ministrisë për limitet e kategorive buxhetore brenda këtij limiti.

Tek investimet kapitale ideja është që të kemi një shtrirje në cdo fshat në cdo lokalitet që propozimet e tyre brenda këtyre viteve të jetësohen.

Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Leutrim Krasniqi, prezanton para të pranishmëve projektet kapitale dhe investimet që i kanë përfshirë në KAB.

Shefki Zeqiri – banor i fshatit Gërdoc - “ne e dim që KAB përmban kërkesat dhe prioritetet tona, fshati jonë ka bërë kërkesa mirëpo nuk po na përgjigjet, ne i kemi prioritet asfaltimin e rrugicave, rregullimin e trotuareve dhe ndriqimin”.

Një banor tjetër potencon problemin me ujë të pijshëm në fshatin Penuhë, problem kemi me disa rregullimin e trotuareve dhe ndriqimin.

Naser Cunaku – përfaqësues i fshatit Llugë, “Sa i përket fshatit tonë, kemi nevojë për rregullimin e rrugëve sekondare, kemi lumin në mes të fshatit që ka nevojë për intervenim, nuk kemi trotuare të ndërtuara, kemi mungesë të këndit të lojërave, shkolla në shkollë është në gjendje jo të mirë, ska infrastrukturë shkolllore”.

Zeqir Ratkoceri –përfaqësues i fshatit Halabak, “ Kërkesa jonë është për një rrugë mbi 2 km, quhet “Baza e Kështjellës” nuk kemi rrymë, nuk kemi kanalizim, nuk kemi ujë, nuk po mundemi me ja dal pa gjëra elementare”.

Drejtori Osmani, i përgjigjet banorit të qytetarit të Llugë sa i përket investimit në shkollë, i cili thotë se është donacion dhe vetëm se kanë filluar procedurat, ndërsa ai vazhdon tu jap sqarimet për prioritetzimin e sektorit të Arsimit.

Naim Mehmeti – banor i fshatit Halabak “Ne kemi bërë kërkesën për ndriqim në fshatin tonë, por ende ska asgjë konkrete, a pritet të bëhet me ndriqim fshati jonë”.

Një banor tjetër potencon problemin me rrugën kah Gërdoci deri të burgu i Dyzit, rruga është shumë e dëmtuar, gjithashtu na mungon ndriqimi, nuk ka një pjesë e sipërme ujë”.

Rrustem Jetullahu – përfaqësues i fshatit Shakovic, “Kemi bërë kërkesë edhe në KAB-in e vtit të kaluar, përvec vazhdimisht të ndriçimit publik dhe funksionalizmit të QMF-së që kanë qene shumë të mirëprituara, ne kemi problemin me rrugica të shkurta të pa asfaltuara. Na kemi bërë kërkesa edhe për fusha futbolli, nëse keni mundësi do të ishim shumë falënderues, ose të paktën ndonjë qendër rekreative për të rinj”.

Drejtori Krasniqi u deklarua se i kanë të evidentuara të gjitha kërkesat e fshatit Shakovicë dhe sipas mundësive buxhetore do t'i përfshijnë.

Ndërsa drejtori Osmani deklroi që sa i përket problemeve me ujë të banorëve të gjitha fshatarve, përgjegjëse është KRU “Prishtina” sepse është në kompetencat e saj, duke shtuar se vetëm eshtë duke bërë përpjekje për zgjidhjen e këtij problemi bashkë më komunën e Podujevës. Gjithashtu thekson që komuna ka trefishuar buxhet sa i përket trajtimit të rrjetit te ujësjellsit.

Një banor tjetër shtron si kërkesë largimin e një deponie ilegale pranë lumit.

Sami Begolli – banor i fshatit Lluzhan, “Kemi problem në Rr. “Begolli” sepse është e gjysmë asfaltuar, e ku ne nuk jemi të përfshirë, rruga është e frekuentuar nga banorët e fshatit Lluzhan dhe Lluga, ne ndihemi të diskriminuar nga komuna, ju lutem të na bëni zgjidhje”.

Ahmet Berisha –banor i fshatit Majac, “Kemi mungesë të kanalizimit, ndriçimit, asfaltimit, ujit dhe shumë projekte elementare për fshatin tonë, ju kasha lut që për vitin e ardhshëm të keni më shumë konsideratë për fshatin Majac”.

Xhevdet Maloku – banor i fshatit Lluzhan, “ Kam disa kërkesa të përbledhura nga banorët e këtij vendi, kërkesa jonë është për asfaltim të rrugëve, fshati jonë ka nevojë për një shkollë moderne, një terren sportive, një kënd të lojrave. Në disa pjesë të fshatit kemi problem me kanalizim, rrugë në gjendje jo të mirë, ne shpresojmë se ju do t'i trajtoni kërkeshat tona”.

Drejtori Osmani iu përgjigjet që shumë kërkesa të qytetarëve të vitit 2021 tani në 6 mujorin e dytë të këtij viti, do të implementohen shumë projekte në fshatra dhe lokacione të ndryshme.

Drejtori Osmani përmbyll dëgjinin duke i falënderuar të gjithë për pjesëmarrjen.

Dëgjimi publik u transmetua online në ueb faqen zyrtare dhe në rrjetin social facebook.

<https://www.facebook.com/KomunaEPodujeves/videos/1163816464412193>

03.06.2022, PODUJEVË




LLAPIO

FATLUM OSMANI - Drejtor i Financave



3:00





Llapi

Komuna e Podujevës - Debat Publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore

TV LLAPI

TV Llapi

Komuna e Podujevës - Debat Publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore

49:24

f



LIVE

TVLLAPI


TV Llapi

Komuna e Podujevës - Debat Publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore

43:04

II 33:36 / 1:09:31

→ C facebook.com/KomunaEPodujeves/videos/1163816464412193



TV Llapi

Komuna e Podujevës - Debat Publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore



Komuna e Podujevës - Debat Publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore

TV Llapi